

A K T T H E M E L I M I
I
S H O Q E R I S E M E P E R G J E G J E S I T E K U F I Z U A R
" H O D A J S H . P . K . "

Me ane te ketij Akti Themelimi, ORTAKU I VETEM, z. ILIR HODAJ, i biri i Hamdiut, i datelindjes 1957, lindur dhe banues ne Vlore, me nr leternjoftimit _____, me adrese: Lagja Pavaresia, Rr."Donika Kastrioti", nr. 266. VLORE.

V E N D O S I

te themeloje Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, emertimi i plote i se ciles eshte : " HODAJ SH.P.K. "

Neni 1 - EMERTIMI, QENDRA DHE AFATI I SHOQERISE


Nga ana e ORTAKUT eshte themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e se drejtes shqiptare (e cila me poshte do te quhet "SHOQERIA". Percaktimet e hollesishme ne lidhje me qellimet dhe objektin e veprimtarise se SHOQERISE, menyren dhe rregullat per funksionimin e saj tregohen me te plota dhe te lidhura me poshte ne kete AKT THEMELUES si edhe ne STATUTIN bashkengjitur.

Emertimi i SHOQERISE do te jete: "HODAJ" Sh.p.k. .

Qendra (selia) legale SHOQERISE eshte ne qytetin e VLORES ne adresen : Lgj." 28 Nentori", Rr."Sadik Zotaj", Pallati i Kapeles, Vlore. Ndryshimi i qendres se SHOQERISE brenda juridiksionit te bashkise se VLORES, nuk passjell ndryshime statutore dhe behet vetem me Vendim te ORTAKUT.

SHOQERIA, me vendim te organeve te saj, mund te themeloje ose anulloje seli sekondare, filiale, perfaqesi, dege dhe agjensi te saj qofte edhe ne shtete te tjera.

Kohezgjatja e SHOQERISE fillon ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar dhe mbaron me ditën e 31 (tridhjetë e një) Dhjetorit te vitit 2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë). ORTAKU ne perputhje me menyren dhe proceduren e percaktuar ne dispozitat e STATUTIT te SHOQERISE mund te zgjate ose te vendose mbarimin e parakohshem te SHOQERISE.



Neni 2 - NATYRA JURIDIKE DHE TREGTARE E SHOQERISE

SHOQERIA eshte person juridik privat i se drejtes shqiptare, veprimtaria e se ciles rregullohet nga ky AKT THEMELUES, STATUTI i saj bashkelidhur dhe legjislacioni shqiptar.

SHOQERIA pergjigjet kundrejt te treteve vetem me pasurite e saj dhe ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e marra persiper nga vete ORTAKU.

ORTAKU pergjigjet per detyrimet e SHOQERISE dhe perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar te SHOQERISE.

SHOQERIA nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

Neni 3 - OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte :

Operacione dhe transaksione te cdo lloji lidhur me importimin, eksportimin, tranzitimin, transportimin dhe tregtimin e mallrave te ndryshme me shumice e pakice ne natyren e produkteve te gatshme, gjysem te gatshme apo te lendes se pare e ne vecanti:

- produkte bujqesore, blegtorale dhe ushqimore ne pergjithesi;
- pajisje elektroshtepiake dhe elektrokulturore;
- pajisje mobilerie, shtepiake dhe zyre;
- konfeksione, metrazhe, pije , duhan, cigare, artikuj industrial e artistike e te tjera mallra te ngjashme me to;
- lende te para, materiale, pajisje dhe makineri ne industrine ndertimore si dhe makineri, pajisje e pjese kembimi ne pergjithesi;
- cfaredo lloj tjetër malli qe paraqet interes ne realizimin e qellimeve dhe objektit te veprimtarise se se kesaj SHOQERIE.

SHOQERIA mund te ushtroje edhe veprimtarine e perfagesimit, te ndermjetesimit apo te lidhjes se kontratave ndermjet subjekteve te ndryshme private apo shteterore, vendase apo te huaja.

SHOQERIA ka te drejten qe te marre pjese ne fitimet dhe/ose ne shoqeri te tjera te se drejtes shqiptare apo te shteteve te tjera si dhe te krijojë shoqeri te tjera tregtare me persona e subjekte publike apo private, vendase ose te huaja.

Neni 4 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themehtar i SHOQERISE ne castin e themelimit te saj eshte ne Leke 100.000 (qind mije), shume kjo e derdhur dhe depozituar per efekt te ligjit ne Banken Kombetare Tregtare, dega e VLORES.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar ne teresine e tyre nga ORTAKU dhe jane shlyer krejtesisht ne te holla ne masen 100% (njeqind per qind) me modalitetet e parashikuara ne ligj. Kapitali themeltar i SHOQERISE mund te rritet nepermjet nenshkrimet dhe derdhjes se kontributeve ne te holla ose me ane te perfshirjes ne te, te vlefes se objekteve apo pasurive te paluajtshme ose te luajtshme te fituara ose qe do te fitohen ne menyra te ndryshme te ligjshme nga SHOQERIA. Vleresimi i tyre behet ne perputhje me nenin 42 te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

ORTAKU ne perputhje me aktet e SHOQERISE, mund te vendose rritjen ose pakesimin e vlefes se kapitalit themeltar.

Cdo veprim lidhur me kapitalin themeltar te SHOQERISE do te behet ne monedhe shqiptare.

Fondet ne te holla te ardhura nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar jane depozituar ne llogarine bankare te hapur ne emer dhe per llogari te SHOQERISE prane Bankes se Kombetare Tregtare, Dega e Vlores.

Ne librin e llogarive te SHOQERISE rregjistrohet kapitali themeltar dhe detajohet kontributi i derdhur nga ORTAKU.

Rregullat mbi transferimin e pjeseve apo gjithe kuotes se pjesmarrjes ne kapitalin themeltar jane parashikuar nga neni 11 i STATUTIT te SHOQERISE bashkengjitur.

Neni 5 - PERSONALITETI JURIDIK

SHOQERIA do te kete zotesi te fitoje te drejta dhe te marre persiper detyrime qe nga casti i rregjistrimit te saj sipas formaliteteve te parashikuar me ligj ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te TIRANES.

SHOQERIA do te filloje ushtrimin e veprimtarive sipas objektit te saj pas perfundimit te formaliteteve sipas ligjes me organin tatimor kompetent dhe organet kompetente per dhenien e autorizimeve te duhura per ushtrimin e atyre veprimtarive.

Neni 6 - VITI FINANCIAR

Viti financiar (ushtrimori) i SHOQERISE fillon ne 1 (nje) Janar dhe mbaron ne 31 (tridhjete e nje) Dhjetor te cdo viti kalendarik. Viti i pare financiar do te mbyllet me 31 Dhjetor 1997 (nentedhjete e shtate).

Neni 7 - FITIMI I SHOQERISE

Destinacioni i fitimit neto te SHOQERISE, mbas zbritjes se detyrimeve fiskale dhe te tjera ne perputhje me ligjin, percaktohet me vendim te ORTAKUT.

Neni 8 - DETYRIME TE ORTAKEVE THEMELUES

Administratoret e SHOQERISE autorizohen qe, bashkerisht ose vecmas, te terheqin kapitalin themeltar te derdhur me paraqitjen e certifikates (vendimit te gjykates dhe asaj te Rregjistrimit prane organit tatimor) qe provon rregjistrimin e SHOQERISE ne Rregjistrin Tregtar dhe ne perputhje me ligjen.

Neni 9 - ORGANET E SHOQERISE

Organet e SHOQERISE jane :

1 - Asamblea e Ortakeve, funksionet e se ciles i mban ORTAKU;

Administrator i Vetem i SHOQERISE eshte zoti ILIR HODAJ, i biri i Hamdiut, i datelindja 1957, lindur dhe banues ne Vlore, ne adresen Lagja. "Pavaresia", Rr. "Donika Kastrioti" nr.266.

Perberja, funksionet dhe kohezgjatja e organeve te SHOQERISE percaktohen ne STATUTIN e saj bashkelidhur dhe pjese perberese e ketij AKTI THEMELUES.

Neni 10 - STATUSI I AKTIT THEMELUES DHE I STATUTIT TE SHOQERISE

SHOQERIA deklarohet e themeluar dhe veprimtaria e saj e rregulluar ne perputhje me dispozitat e ketij AKTI THEMELUES dhe te STATUTIT te SHOQERISE dhe, te cilat, jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 11 - SHPENZIMET E THEMELIMIT TE SHOQERISE

Shpenzimet per hartimin dhe nenshkrimin e ketij AKTI THEMELUES ashtu si edhe cdo shpenzim per njohjen ligjore dhe rregjistrimin e SHOQERISE jane ne ngarkim te kesaj te fundit.


Neni 12 - DISPOZITE E FUNDIT

Ky AKT THEMELUES u hartua 5 kopje origjinale. Dy nga origjinalet i mban SHOQERIA ndersa te tjerat do te depozitohen perkatesisht prane Rregjistrin Tregtar, noterit dhe organit tatimor kompetent.

ORTAKU pasi e lexoi, e kuptoi dhe pranoi kete AKT THEMELUES, e nenshkroi ate sot ne daten 07.01.1997 ne prani te Noterit dhe qe e ben te vlefshem kete veprim juridik.

O R T A K U

ILIR HODAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr.....9.....Rep

Nr.....7.....Kol

Tirane, me 07.01.1996


V E R T E T I M

Ne Tirane sot me date 07.01.1996 (nentehdjete e dhate).
para meje Noterit Halim Islimi u paraqit zoti Ilir Hodaj, i
biri i Hamdiut, i datelindjes 1957, lindur dhe banues ne Vlore,
ne adresen: Lagja "Pavaresia" Rruga Donika Kastrioti, nr. 266,
me leternjoftim _____, per identitetin e te cilit u
sigurova nga dokumenti identifikues qe me paraqiti, madhor dhe
me zotesi per te vepruar, i cili me kerkoj vertetimin sipas
ligjes te ketij AKTI THEMELUES te Shoqerise tregtare me
pergjegjesi te kufizuar me emertimin "HODAJ" Sh.p.k. dhe pasi,
ne pranine time, e lexoi, e kuptoi, e pranoi dhe e nenshkroi, Une
Noteri duke e gjetur kete veprim te rregullt dhe te mbeshtetur
ne ligj e vertetoj dhe e nenshkruaj ate sipas ligjit.

N O T E R I

Halim Islimi

[Signature]



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "HODAJ" Sh.p.k.

Shoqeria Tregtare "HODAJ" Sh.p.k. (e cila ketu me poshte quhet "SHOQERIA") eshte themeluar ne baze te Aktit Themelues te nenshkruar (me poshte i quajtur "AKTI THEMELUES") nga zoti ILIR HODAJ, i biri i Hamdiut, i datelindjes 1957, lindur dhe banues ne Vlore ne adresen Lgj."Pavaresia",Rruga "Donika Kastrioti", nr. 266, (me poshte i quajtur "ORTAKU").

ORTAKU, pervec sa eshte parashikuar ne AKTIN THEMELUES, ka vendosur qe rregullat mbi veprimtarine e SHOQERISE do te parashikohen nga ky

STATUT i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "HODAJ" Sh.p.k.

T I T U L L I 1

Emertimi - Qendra - Kohezgjatja - Objekti

Neni 1 - EMERTIMI I SHOQERISE

SHOQERIA do te kete emertimin : "HODAJ" Sh.p.k. .

Neni 2 - QENDRA E SHOQERISE - VENDBANIMI I ORTAKEVE

Qendra e SHOQERISE ndodhet ne VLORE ne adresen Lgj.28 Nentori, Rr."Sadik Zotaj", Pallati i Kapeles. Ndryshimi i qendres se SHOQERISE brenda juridiksionit te bashkise se VLORES nuk passjell modifikimin statutor dhe kryhet me vendim te ORTAKUT.

SHOQERIA, me vendim te ORTAKUT ose te Administratorit te SHOQERISE mund te themeloje, transferoje ose anulloje seli dytesore, seli administrative, filiale, agjensi, dege, perfaqesi dhe zyra edhe ne lokalitete te tjera, si ne territorin e Republikes se Shqiperise ashtu edhe jashte tij.

Neni 3 - KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e SHOQERISE fillon ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar dhe mbaron ditën e 31 (tridhjetë e një) Dhjetorit te vitit 2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë).



Neni 4 - OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte :

Operacione dhe transaksione te cdo lloji lidhur me importimin, eksportimin, tranzitimin, transportimin dhe tregtimin e mallrave te ndryshme me shumice e pakice ne natyren e produkteve te gatshme, gjysem te gatshme apo te lendes se pare e ne vecanti:

- produkte bujqesore, blegtorale dhe ushqimore ne pergjithesi;
- pajisje elektroshtepiake dhe elektrokulturore;
- pajisje mobilerie, shtepiake dhe zyre;
- konfeksione, metrazhe, pije, duhan, cigare, artikuj industrial e artistike e te tjera mallra te ngjashme me to;
- lende te para, materiale, pajisje dhe makineri ne industrine ndertimore si dhe makineri, pajisje e pjese kembimi ne pergjithesi;
- cfaredo lloj tjeter malli qe paraqet interes ne realizimin e qellimeve dhe objektit te veprimtarise se se kesaj SHOQERIE.

SHOQERIA mund te ushtroje edhe veprimtarine e perfaqesimit, te ndermjetesimit apo te lidhjes se kontratave ndermjet subjekteve te ndryshme private apo shteterore, vendase apo te huaja.

SHOQERIA ka te drejten qe, brenda kufijve te parashikuara ne legjislacionin shqiptar, duke perjashtuar cdo qellim spekulativ, te marre pjese ne fitime dhe/ose ne shoqeri te tjera te se drejtes shqiptare apo te shteteve te tjera si dhe te krijoje shoqeri te tjera tregtare me persona e subjekte publike apo private, vendase ose te huaja.

Neni 5 - PERGJEGJESIA E SHOQERISE

SHOQERIA pergjigjet kundrejt te treteve vetem me pasurite e saj dhe, ne asnje rast, ajo nuk pergjigjet per detyrimet e marra persiper nga ORTAKU dhe as keta te fundit nuk perballojne detyrimet dhe humbjet e SHOQERISE pertej kufirit te vleftes se kuotes se pjesmarrjes se tyre ne kapitalin themeltar te saj.

SHOQERIA nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

Neni 6 - CILESIA E ORTAKUT. HUMBJA E TIJ

Cilesia e ORTAKUT vetekupton konsiderimin e qendres se SHOQERISE si adrese dhe vendodhje te ORTAKUT si edhe pranimin pa asnje kusht te dispozitave te AKTIT THEMELUES, te STATUTIT, te vendimeve te Asamblese se Ortakeve, edhe sikur dispozita te tilla te kene hyre ne fuqi perpara fitimit te cilesise se ORTAKUT.

Ne rast te humbjes se cilesise se ORTAKUT, kuotat e tij do tu kalojne ORTAKEVE te tjere ne proporcion me pjesmarrjen e tyre ne kapitalin themeltar te cilet, gjithmone po sipas te njejtit kriter do ti derdhin ORTAKUT qe ka humbur cilesine e tille vetem vleren nominale te atyre kuotave.

T I T U L L I 2

Kapitali themeltar - Transferimi i pjeseve te tij

Neni 7 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i SHOQERISE ne castin e themelimit te saj eshte ne Leke 100.000. (njëqind mije), shume kjo e derdhur dhe depozituar per efekt te ligjit ne Banken Kombetare Tregtare, dega e Vlores.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar ne teresine e tyre nga ORTAKU dhe jane shiyer krejtesisht ne te holla ne masen 100% (njeqind per qind) me modalitetet e parashikuara ne ligj.

Kapitali themeltar i SHOQERISE mund te rritet nepermjet nenshkrimet dhe derdhjes se kontributeve ne te holla ose me ane te perfshirjes ne te, te vlefes se objekteve apo pasurive te paluajtshme ose te luajtshme te fituara ose qe do te fitohen ne menyra te ndryshme te ligjshme nga SHOQERIA. Vleresimi i tyre behet ne perputhje me nenin 42 te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

ORTAKU ne perputhje me aktet e SHOQERISE, mund te vendose rritjen ose pakesimin e vlefes se kapitalit themeltar.

Cdo veprim lidhur me kapitalin themeltar te SHOQERISE do te behet ne monedhe shqiptare.

Fondet ne te holla te ardhura nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar jane depozituar ne llogarine bankare te hapur ne emer dhe per llogari te SHOQERISE prane Bankes Kombetare Tregtare, dega Vlore.

Ne librin e llogarive te SHOQERISE rregjistrohet kapitali themeltar dhe detajohet kontributi i derdhur nga ORTAKU.

Neni 8 - E DREJTA E PARABLERJES DHE CEDIMI OSE TRANSFERIMI

Kuotat e pjesmarrjes ne SHOQERI jane personale dhe te transferueshme.

Trashegimtaret e ORTAKUT te vdekur, qe ne kuptim te ketij STATUTI do te quhen dhe caktohen vetem femijet e ligjshem, e zevendesojne pa kufizime ne te drejta trashegimtarin e tyre te vdekur.

Ne rast te cedimit te kuotave nga ana e nje ORTAKU, ceduesi ka si detyrim te njoftoje ORTAKET e tjere, ne menyre qe ata te ushtrojne te drejten e parablerjes.

Ne oferten e cedimit, e cila u behet e ditur te gjithe ORTAKAVE me leter rekomande, ORTAKU cedues duhet te tregoje vleren e cedimit dhe emerine e blesesit.

ORTAKET duhet te ushtrojne te drejten e parablerjes per te fituar ato kuota ose te njoftojne vullnetin e tyre se heqin dore nga



blerja e tyre, brenda tridhjete diteve nga njoftimi si me siper. Ne rast te ushtrimit te se drejtes se parablerjes ORTAKET i blejne kuotat qe cedohen ne proporcion me pjesmarrjen e tyre ne SHOQERI.

Ne rastin kur cmimi i kerkuar per cedimin e kuotave konsiderohet jo i drejte dhe i tepruar nga ORTAKET e tjere, keta te fundit duhet te kundershtojne ate vlere shitjeje brenda 30 (tridhjete) diteve nga njoftimi dhe cmimi do te percaktohet nga nje ekspert ne baze te rezultateve te arritura ne bilancin e fundit te miratuara.

Cedimet e kryera te treteve pa respektuar kriteret e treguara me siper ne kete nen ose me nje cmim me te ulet nga ai i kerkuar nga ceduesi ORTAKEVE, jane te pavlefshme (nul) dhe nuk do te sjellin pasoje kundrejt ORTAKEVE dhe SHOQERISE; pervec sa me siper do te zbatohen te drejttat e ORTAKVE per te blere keto kuota me cmimin e ulet te paguar nga personi i trete.

Neni 9 - OPERACIONET FINANCIARE

SHOQERIA ka te drejten e kerkimit dhe pranimit te burimeve te financimit apo kredive, hua etj. duke iu drejtuar bankave dhe instituteve financiare qe e gezojne te drejten e financimit dhe kreditimit.

Neni 10 - BLERJET E SHOQERISE

SHOQERIA disponon dhe gezon pasurite e saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e themelimit te saj.

SHOQERIA ka te drejten e blerjes dhe administrimit te pasurive te cdo lloji e natyre si dhe te jape garanci si mjet sigurimi mbi pasurite e saj per permbushjen e detyrimeve qe merr persiper kundrejt te treteve.

T I T U L L I 3

Financat e SHOQERISE - Bilanci

Neni 11 - BILANCI DHE FONDET E SHOQERISE

SHOQERIA per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon fondet e nevojshme si dhe fondin rezerve e fonde per zhvillim. Perberja, madhesia e tyre, burimet e krijimit, perdorimi e rregullimi i cdo fondi te vecante ne perputhje me rrethanat, interesat dhe objektin e veprimtarise se SHOQERISE, vendosen nga ORTAKU dhe Administratori i SHOQERISE duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi.

SHOQERIA disponon mjetet e saj financiare. Te gjitha detyrimet e mundshme gjate veprimtarise se SHOQERISE do te perballohen nga fondet perkatese apo fonde rezerve ose si alternative, me ane te zmadhimit te kapitalit themeltar. Te gjitha pasurite e SHOQERISE pasqyrohen ne bilancin e saj me vlefte te shprehur ne monedhe shqiptare.



Bilanci dhe llogarite e SHOQERISE perpilohen nga Administratoret e SHOQERISE sipas modaliteteve mbi bilancin e kontabilitetin e shoqerive tregtare te legjislacionit financiar ne fuqi.

Viti financiar (ushtrimori) fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Viti i pare financiar mbyllet ne daten 31 (tridhjete e nje) Dhjetor 1996 (nentedhjete e gjashte).

Bilanci vjetor zyrtar detyrimisht i paraqitet Asamblese se Ortakeve brenda tre muajve nga data e mbarimit te cdo viti financiar.

Ne perfundim te cdo viti financiar, Administratoret e SHOQERISE nerrin masat e duhura per pergatitjen dhe perfundimin e bilancit te SHOQERISE, bazuar ne kritere te perzgjedhura me kujdesin maksimal duke respektuar dispozitat ligjore mbi bilancin dhe kontabilitetin e shoqerive tregtare te legjislacionit shqiptar.

Bilancit te SHOQERISE i bashkengjitet nje relacion permbledhes mbi veprimtarine e zhvilluar nga SHOQERIA gjate atij viti financiar.

Bilanci dhe relacioni i veprimtarise se SHOQERISE i paraqiten per miratim Asamblese se Ortakeve.

Neni 12 - SHPERNDARJA E FITIMIT

Destinacioni i perdorimit te fitimit neto, pas zbritjes se shumave te detyruara per pagimin e tatimeve, taksave dhe detyrimeve te tjera ligjore, te shumave per celjen e fondeve te rezerves e fonde te tjera te nevojshme, do te vendoset nga ORTAKU.

T I T U L L I 4

Asambleja e Ortakeve - Administrimi i SHOQERISE

Neni 13 - ASAMBLEA E ORTAKEVE

Te gjitha fuqite dhe kompetencat qe legjislacioni shqiptar dhe praktiket lokale dhe nderkombetare i njohin ASAMBLESE se ORTAKEVE ushtrohen nga ORTAKU dhe gjithmone ne perputhje me ligjin, me AKTIN THEMELUES dhe me kete STATUT.

Neni 14 - KOMPETENCA TE ZAKONSHME DHE TE JASHTEZAKONSHME

ORTAKU vendos ne menyre te vecante :

- 1 - per miratimin e bilancit vjetor te SHOQERISE ;
- 2 - per emerimin e Administratoreve te SHOQERISE;
- 3 - per perdorimin e fitimit ;
- 4 - per ndryshimin e dispozitave te STATUTIT dhe te AKTIT THEMELUES;
- 5 - per zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit themeltar te SHOQERISE;

5

- 6 - per zgjatjen e afatit ose prishjen e parakohshme te SHOQERISE apo ndryshimin e formes se shoqerise;
- 7 - per emerimin e likujdusesit ose likujdusesve dhe percaktimin e te drejtave dhe kompetencave te tyre :

Neni 15 -

ORTAKU, ushtron kompetencat treguar ne nenet 14 dhe 15 mesiper se paku se paku nje here ne vit, por jo me vone se 3 (tre) muaj nga perfundimi i vitit financiar.

Neni 16 - ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administrimi i SHOQERISE ushtrohet nga ADMINISTRATORI i VETEM i emeruar nga vete ORTAKU i cili, qendron ne kete funksion per nje periudhe qe ORTAKU e percakton ne aktin e emerimit, pervec rasteve te doreheqjes ose te revokimit ne cfaredo kohe nga ana e tij.

Neni 17 - KOMPETENCA TE ADMINISTRATOREVE

Administratoret e SHOQERISE kujdesen dhe veprojne me fuqite dhe kompetencat me te gjera lidhur me drejtimin e SHOQERISE dhe, ne menyre me te posacme, bashkerisht ose vecmas, kane te drejtat e zbatimit dhe te realizimit te qellimit dhe te objektit te veprimtarise se SHOQERISE, me perjashtim te atyre qe ne baze te ligjit, AKTIT THEMELUES, STATUTIT i takojne ne menyre taksative dhe eskluzive ORTAKUT.

Neni 18 - KOMPETENCAT TE ADMINISTRIMIT

Administratorit (-eve) te SHOQERISE, bashkerisht ose vecmas, u takojnene menyre te vecante kompetencat si vijon :

- 1- zbatimi i vendimeve te ORTAKUT;
- 2- organizimi dhe drejtimi i punes per permbushjen e objektit te SHOQERISE, duke relatuar perpara ORTAKUT;
- 3- administrimi i pasurive dhe mjeteve te SHOQERISE, perfshire mjetet financiare, ne perputhje me dispozitat e STATUTIT, AKTIT THEMELUES, vendimet e ORTAKUT ose ne aktet ligjore;
- 4- drejtimi dhe kontrolli i veprimtarise se filialeve, agjensive, perfaqesive, zyrave e te tjera si keto te themeluara nga SHOQERIA.
- 5- lidhja e kontratave te cdo lloji e natyre ne emer dhe per llogari te SHOQERISE.
- 6- kryerja e cdo pagese qe detyrohet SHOQERIA, hapja ose mbyllja llogari bankare te SHOQERISE si edhe te depozitoje, terheqe ose transferimi i te hollave nga keto llogari;
- 7 -marrja dhe pushimi nga puna i personelit te SHOQERISE dhe te nenshkrimi i kontratave perkatese.

Administratoret, bashkerisht ose vecmas jane pergjegjes ndaj SHOQERISE per detyrimet qe jane brenda kompetences se tij eskluzive.

Neni 19 - PERFAQESIMI DHE FIRMA E SHOQERISE

Te drejten e Firmes dhe te perfaqesimit te SHOQERISE edhe perpara gjykates, bashkerisht ose vecmas, e kane Administratoret e SHOQERISE.

Administratoret e SHOQERISE kane te drejte te delegojnee te drejten e firmes duke emeruar nje ose me shume prokurues te posacem, me perjashtim te se drejtes per te emeruar prokurues te pergjithshem.

Neni 20 - KONTROLLI I AKTIVITETIT EKONOMIKO-FINANCIAR

Per kontrollin e veprimtarise se SHOQERISE, ORTAKU emerone nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar.

Keta eksperte kontabel, emerohen per cdo vit ushtrimor, jane te riemcrueshemn dhe nuk duhet te jene punonjes te SHOQERISE ose te filialeve, agjensive, perfaqesive te saj.

Neni 21 - MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ndermjet SHOQERISE, filialeve e agjensive te saj dhe punonjesve te tyre rregullohen me kontraten e punes. Per ceshtje te paparashikuara ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi, apo te vendit ku ndodhet filiali, perfaqesia, agjencia etj.

T I T U L L I 5

Mbarimi - Prishja - Likuidimi

Neni 22 - PRISHJA E SHOQERISE

SHOQERIA priset ne rastet kur ;

- 1 - mbaron afati i parashikuar ne AKTIN THEMELUES ;
- 2 - nuk mund te realizohet objekti i SHOQERISE sipas AKTIT THEMELUES dhe STATUTIT;
- 3 - nje vendim te tille e merr ORTAKU;
- 4 - ne rastet e parashikuara ne ligj.

Neni 23 - LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast te prishjes se SHOQERISE ne cfaredo kohe dhe per cfaredo arsye ORTAKU emerone nje ose disa likuidatore.

Likuidimi i SHOQERISE do te behet sipas dispozitave te legjislacionit falimentar shqiptar ne fuqi ne castin e likuidimit.

ORTAKU vendos rregullat per proceduren e likuidimit, per personat qe do ti aplikojne ato, e per shperblimin e kompetenca te tjera te tyre.



Ne perfundim te procedurave te likujdimit pasuria neto qe i mbetet SHOQERISE i takon ORTAKUT.

Neni 24 - MBARIMI I FILIALEVE

Mbarimi i veprimtarise se filialeve, perfaqesive agjensive etj. vendoset nga ORTAKU. Likujdimi i tyre kur jane vendosur jashte shtetit rregullohet nga legjislacioni i shtetit ne te cilin jane vendosur.

T I T U L L I 6

D I S P O Z I T A T E F U N D I T

Neni 25 - DISPOZITA TE ZBATUESHME PER SHOQERINE

Marredheniet ne SHOQERI rregullohen nga dispozitat e AKTIT THEMELUES, STATUTIT, Vendimet e ORTAKUT dhe te Administratoreve te SHOQERISE dhe qe jane ne perputhje me ligjin. Per marredhenie dhe probleme qe nuk jane trajtuar shprehimisht ne aktet e mesiperme, do te zbatohen dispozitat e akteve ligjore dhe nenligjore te fushes tregtare ose ne pergjithesi.

Neni 26 - DISPOZITE E FUNDIT

Ky STATUT hyn ne fuqi ditën e rregjistrimit te SHOQERISE ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranës.

Ky STATUT u hartua ne 5 origjinale . Dy nga origjinalet i mban SHOQERIA dhe te tjerat depozitohen perkatesisht prane Rregjistrin Tregtar, Noterit dhe organit kompetent tatimor.

ORTAKU pasi e lexoi, e kuptoi dhe e pranoi kete STATUT, e nenshkroi ate sot me daten 02.01.1993 ne prani te Noteres.

O R T A K U

ILIR HODAJ

Ky S T A T U T u perpilua nga Av. ARDIAN DVORANI

ZYRA AVOKATORE
" SADUSHI & DVORANI "

Adresa: Bul. "Zhan D'Ark",
Pall. Shallvare.
Tel: + 355 42 422 66
TIRANE - ALBANIA